

19.10.2020

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AKM GROUP” SH.P.K.**

**TITULLI I
EMRI I SHOQËRISË, FORMA, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1
Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është “AKM GROUP” SH.P.K.

**Neni 2
Forma**

- 2.1. Shoqëria “AKM GROUP” SH.P.K. (më poshtë referuar shkurt si “**Shoqëria**”), themelohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi, nga ky Statut, dhe nga akti i themelimit përkatës.
- 2.2. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar me karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to rregullohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 3
Objekti i Shoqërisë**

- 3.1. Shoqëria ka si objekt veprimtarie ushtrimin e aktivitetit tregtar lidhur me Bar Restorant, Hoteleri Turizëm, Ndërtim Objektsh.
- 3.2. Më gjerësisht, Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër nevojshëm ose të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj, me legjislacionin shqiptar në fuqi

**Neni 4
Selia**

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në adresën : **Rr. Marko Boçari, nr. 6, Shk. 1, ap. 47, Tiranë AL, 1001.**

- 4.2 Transferimi i selisë në një adresë tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Neni 5
Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të shpërndalet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.


TITULLI II
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NNDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6
Kapitali

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 100 000 Lek (Njëqind mijë Lek).
- 6.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të gjitha të nënshkruara, me vlerë nominale prej ALL 50 000 Lek (Pesëdhjetë mijë Lekë) secila.

Neni 7
Kontributet dhe kuotat

- 7.1. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:
1. Z. Kristi Muçobega, shtetas Shqiptar , i biri i Arben –it, lindur në Fier, më 01.06.1999 dhe banues në Tiranë Rr. Muharrem Butka, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal, J90601090M , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili ka kontribuar në vlerën ALL 50 000 Lek (pesëdhjetë mijë lekë); dhe
 2. Z. Armand Mucobega, Shtetas Shqiptar, i biri i Muharrem –it, lindur në Memaliaj dhe banues në Tiranë, Rr. Muharrem Butka, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal , 180716133H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili ka kontribuar në vlerën ALL 50 000 lek (pesëdhjetë mijë lekë).
- 7.2. Sipas kontributeve të mësipërme, zotërimi i kuotave të Shoqërisë pasqyrohet si më poshtë vijon:
1. Z. Kristi Muçobega, shtetas Shqiptar , i biri i Arben it, lindur në Fier, më 01.06.1999 dhe banues në Tiranë Rr. Muharrem Butka, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal, J90601090M , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar,; të cilit i përket 1 (Një) kuotë, që i korrespondon 50 % (pesëdhjetë %) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë; dhe



2. Z. Armand Mucobega, Shtetas Shqiptar, i biri i Muharrem –it, lindur në Memaliaj dhe banues në Tiranë, Rr. Muharrem Butka, mbajtës i letënjoftimit me nr. personal , I80716133II, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; të cilit i përket 1 (Një) kuotë, që i korrespondon 50 % (pesëdhjetë %) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 8

Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast, vendimi i Asamblesë së Ortakëve duhet të merret sipas kuorumit të përcaktuar në nenin 12.3 më poshtë.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë rritjen e kapitalit në përpjesëtim me kuotat e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Në rast se ortakët vendosin të nënshkruajnë rritjen e kapitalit, ata duhet t'ua komunikojnë këtë vendim ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve nga vendimi i Asamblesë për rritjen e kapitalit. Në rast se komunikimi i mësipërm nuk bëhet brenda këtij afati, ortaku konsiderohet të ketë hequr dorë nga e drejta për të nënshkruar rritjen e kapitalit themeltar.
- 8.3 Në rastin kur Shoqëria ka një ortak të vetëm, rritja e kapitalit bëhet me vendim të Ortakut të vetëm i cili mund të nënshkruajë të gjithë rritjen e kapitalit ose një pjesë të tij. Pjesa e shumës së panënshkruar, në qoftë se ka të tillë, mund të nënshkruhet nga persona të tretë.

Neni 9

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të Asamblesë së Ortakëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast vendimi i Asamblesë së Ortakëve duhet të merret sipas kuorumit të përcaktuar në nenin 12.3 më poshtë. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit themeltar përballohet nga secili prej ortakëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar.

Neni 10

Transferimi i kuotave

- 10.1 Transferimi *inter vivos* i kuotave të Shoqërisë personave të tretë i nënshtrohet të drejtës së parblerjes në favor të ortakëve të tjerë, në rast se ka të tillë, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë në përputhje me rregullat e parashikuara më poshtë në Nenet 10.2 deri në 10.6.
- 10.2 Në rast se një nga ortakët (“**Transferuesi**”) vendos të shesë dhe/ose transferojë një pjesë ose të gjitha kuotat e tij, ortakët e tjerë (“**Ortakët e Tjerë**”) do të kenë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat që do të transferohen (“**Kuotat e Ofruara**”) sipas kushteve të mëposhtme:



- (a) Transferuesi duhet t'u komunikojë paraprakisht me shkrim Ortakëve të Tjerë, me anë të një letre rekomande me njoftim marrjeje, apo nëpërmjet një adrese elektronike të deklaruar paraprakisht nga secili ortak pranë Shoqërisë, dëshirën e tij për të transferuar pjesët e kapitalit, numrin e Kuotave të Ofruara, çmimin dhe kushtet e transferimit ("Oferta"), duke u propozuar Ortakëve të Tjerë të blejnë Kuotat e Ofruara;
- (b) Ortakët e Tjerë do të kenë të drejtën, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar, të blejnë Kuotat e Ofruara sipas kushteve të Ofertës, me anë të një komunikimi me shkrim dërguar Transferuesit brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së Ofertës.
- 10.3 Në rast se vetëm një pjesë e Ortakëve të Tjerë dëshirojnë të blejnë Kuotat e Ofruara, secili prej tyre do të ketë të drejtë të blejë Kuotat e Ofruara në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë, me anë të një komunikimi me shkrim dërguar Transferuesit brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së komunikimit të Transferuesit sipas të cilit vetëm një pjesë e Ortakëve të Tjerë dëshiron të blejë Kuotat e Ofruara.
- 10.4 Në rast se asnjë nga Ortakët e Tjerë nuk dëshiron të blejë Kuotat e Ofruara dhe/ose refuzon t'i blejë ato, Transferuesi do të ketë të drejtën t'i transferojë Kuotat e Ofruara një personi të tretë (sipas kushteve të Ofertës).
- 10.5 Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rast transferimi të kuotave nga secili prej ortakëve të Shoqërisë tek një shoqëri tjetër e kontrolluar prej tyre, ose, tek një paraardhës, pasardhës ose bashkëshort i tyre.
- 10.6 Parashikimet e nenit 10 nuk zbatohen në rast transferimi të kuotave midis ortakëve të Shoqërisë. Në çdo rast, transferimi duhet t'i komunikohet paraprakisht me shkrim ortakëve të tjerë. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë nen duhet t'i dërgohen edhe Shoqërisë.
- 10.7 Çdo transferim i të drejtës së pronësisë mbi kuotat, si edhe krijimi apo transferimi i çdo të drejte tjetër mbi to duhet të regjistrohet në regjistrin e ortakëve.

TITULLI III ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

Neni 11

Asambleja e Ortakëve, pjesëmarrja, e drejta e votës dhe thirrja e asamblesë

- 11.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve, në të cilën marrin pjesë të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 11.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asambleshë e Ortakëve, të shprehë opinionin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që ai zotëron.
- 11.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, qoftë ky ortak ose jo ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e të cilit mund të japë votën e tij. Në çdo rast prokura mund të lëshohet vetëm për pjesëmarrjen në një Asamble Ortakësh dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.

- 11.4 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 11.5 Asambleja e Ortakëve mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda ose jashtë Shqipërisë.
- 11.6 Asambleja e Ortakëve mund të thirret nga një prej Administratorëve në rast se kjo është e nevojshme për interesat e Shoqërisë ose kërkohet nga ligji. Në çdo rast Asambleja e Ortakëve duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda muajit të Qershorit, për të diskutuar, analizuar dhe miratuar bilancin vjetor të vitit fiskal paraardhës.
- 11.7 Asambleja e Ortakëve duhet të thirret me letër rekomande me njoftim marrjeje ose me postë elektronike që duhet t'u dërgohet ortakëve në banesën e tyre ose në adresën e postës elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 11.8 Njoftimi i thirrjes së Asamblesë duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen dhe mbi të cilat do merret vendim, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë, vendin, mënyrën e konsultimit të dokumentacionit të Asamblesë si dhe elementë të tjerë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
- 11.9 Asambleja do të quhet rregullisht e mbledhur edhe nëse formalitet e thirrjes nuk respektohen, me kusht që ortakët që përfaqësojnë kapitalin e plotë të jenë të pranishëm apo të përfaqësuar dhe të jenë dakord të mbajnë Asamblesën edhe pse formalitet e lartpërmendura nuk janë respektuar.
- 11.10 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe video konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u lejohej të ndjekin diskutimin, të ndërhyjnë në kohë reale dhe të konstatohet rregullisht mënyra e votimit të tyre; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari dhe/ose sekretari i Asamblesë.
- 11.11 Asambleja e Ortakëve kryesohet nga një kryetar i emëruar midis ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar në Asamble. Në rast se prania e një noteri nuk është e nevojshme, Asambleja emëron një sekretar, i cili mund të jetë ortak ose jo.
- 11.12 Kryetari i Asamblesë së Ortakëve ka të drejta të plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble, dhe për të vendosur nëse kjo e fundit është thirrur rregullisht dhe nëse është arritur kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime të rregullta. Kryetari ka edhe të drejtën për të kryesuar diskutimet dhe për të vendosur rregullat dhe procedurat në lidhje me votimin.
- 11.13 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i Asamblesë si dhe nga noteri kur është e nevojshme. Në çdo rast që nevojitet nënshkrimi i secilit dhe/ose një pjesë të ortakëve, si rrjedhojë e pamundësisë objektive fizike për të qenë të mbledhur fizikisht në të njëjtin vend dhe kohë, ortakët mund të nënshkruajnë të vetëm kopje të ndryshme të të njëjtit format, ose e firmosur elektronikisht, me kusht që kopjet përkatëse të konfirmohen rregullisht nga sekretari dhe janë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- 11.14 Në rastin kur Shoqëria ka një ortak të vetëm Asambleja e Ortakëve përbëhet dhe kryesohet nga ky ortak i Vetëm, pa qenë nevoja e të pasurit të një sekretari. Vendimet e Ortakut të vetëm kanë vlerën dhe efektin e vendimeve të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 12

Kuorumi dhe kompetencat e Asamblesë së Ortakëve

- 12.1 Asambleja mund të marrë vendime me shumicë të zakonshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave me të drejtë vote. Në rast se ky kuorum nuk arrihet në mbledhjen e parë, Asambleja do të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga mbledhja e parë. Vendimet që merren me shumicë të zakonshme janë të vlefshme nëse miratohen nga shumica e ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar.
- 12.2 Asambleja merr vendime me shumicë të zakonshme mbi:
- (a) politikat e biznesit;
 - (b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve;
 - (c) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit/ëve kontabël i/të autorizuar dhe vendosjen e shpërblimeve përkatëse;
 - (d) miratimin e raporteve të ecurisë së biznesit;
 - (e) ndryshimin e planit për nxitjen e administrimit ose miratimin e një plani të ri për nxitjen e administrimit;
 - (f) miratimin ose ndryshimin e çdo plan biznesi ose buxheti;
 - (g) ndryshimet në drejtimin strategjik, zonën gjeografike ose linjat e biznesit të Shoqërisë;
 - (h) përthithjen ose themelimin e një filiali të ri ose blerjen e çdo pjesëmarrjeje apo tituj të rreth të një shoqërie;
 - (i) shitjen ose blerjen e aseteve (me anë të blerjes së pjesëmarrjes ose aseteve, me bashkim ose ndryshe) vlera e të cilave nuk tejkalon 20% (njëzetë për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas bilancit të fundit të certifikuar;
 - (j) marrjen përsipër të çdo detyrimi ose vendosjen peng të aseteve të Shoqërisë të cilat nuk tejkalojnë vlerën kontabël prej 20% (njëzetë për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas bilancit të fundit të certifikuar;
 - (k) shitjen e aseteve, kuotave dhe dhënien me qira të ndërmarrjes, pjesëmarrjeve në shoqëri, bashkime apo forma të tjera;
 - (l) pjesëmarrje në *joint-venture*, *partnership*-e, bashkime ose forma të ngjashme;
 - (m) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera kundër Administratorit/ëve;
 - (n) çdo çështje tjetër të përcaktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 12.3 Asambleja mund të marrë vendime të jashtëzakonshme me të njëjtin Kuorum sipas pikës 12.2 edhe për:
- (a) ndryshimin ose shtesat në Statutin e Shoqërisë;




- (b) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit;
- (c) miratimin e bilancit vjetor dhe shpërndarjen e fitimeve;
- (d) ndarjen e kuotave;
- (e) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
- (f) ristrukturimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, thithjen, ndarjen ose likuidimin e Shoqërisë ose ri-organizimin e Shoqërisë në një formë tjetër;
- (g) ndërmarrjen e çdo veprimi që në mënyrë të pritshme do të shkaktoonte një rast likuidimi;
- (h) themelimin, blerjen ose shitjen e çdo filiali;
- (i) shitjen ose blerjen e aseteve (me anë të blerjes së pjesëmarrjes ose aseteve, me bashkim ose ndryshe) në çdo rast që kjo gjë kërkohet nga administratori; dhe
- (j) marrjen përsipër çdo detyrim ose vendosjen peng të aseteve të Shoqërisë të cilat tejkalojnë vlerën kontabël prej 20% (njëzet për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas bilancit të fundit të certifikuar.

Neni 13 Administratori/ët

- 13.1 Shoqëria administrohet nga një ose nga një numër maksimal prej 2 (dy) administratorësh, të cilët mund të jenë ortakë ose jo, dhe emërohen nga Asambleja e Ortakëve.
- 13.2 Administratorët emërohen për një periudhë 5 Pesë vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 14 Kompetencat e administratorit/ëve

- 14.1 Administratorët janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm. Administratorët kanë të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që i janë dhënë organeve të tjera të Shoqërisë nga Statuti ose ligji i zbatueshëm. Në rast të më shumë se një Administratori, Asambleja mund të vendosë që një ose më shumë Administratorë mund të veprojnë bashkërisht ose veçmas.
- 14.2 Administratori/ët kanë kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:
 - (a) të zbatojnë politikën e biznesit të Shoqërisë;
 - (b) të thërrasin Asamblenë nëse kjo është e nevojshme për interesat e Shoqërisë;
 - (c) të sigurohen që Shoqëria zbaton ligjet në fuqi dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
 - (d) të shqyrtojnë dhe të mbajnë librat e Shoqërisë, dokumentet dhe asetet;
 - (e) të sigurohen që bilanci vjetor si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose Statutit realizohen në mënyrën e duhur;
 - (f) të sigurohen që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga eksperti kontabël i autorizuar dhe që raporti i këtij të fundit të vihet në dispozicion të ortakëve;

- (g) të miratojnë blerjen e aseteve pa kufizim për qëllimet e aktivitetit të Shoqërisë. Në raste kur e vlerëson të arsyeshme, mund t'i kërkojë asamblesë së ortakëve miratimin paraprak të këtyre veprimeve;
- (h) të marrin përsipër çdo detyrim me një vlerë kontabël të pakufizuar;
- (i) të vendosin për rritjen ose zvogëlimin e pjesëmarrjes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Shoqërisë në çdo filial;
- (j) të bëjnë çdo ndryshim në të dhënat e referencës së llogarive ose në politikat e mbajtjes së llogarive;
- (k) të emërojnë, të shkarkojnë, të përcaktojnë shpërblimin dhe kushtet e punësimit të çdo punonjësi;
- (l) të hyjnë në çdo marrëveshje ose angazhim, me një palë të tretë apo filial; dhe
- (m) çdo kompetencë ose detyrë tjetër të përcaktuar nga ligji ose ky Statut.

- 14.3 Administratori/ët kanë të drejtë që të autorizojnë, apo të lëshojnë prokurë të veçantë ose të përgjithshme, një ose me shumë persona ose grupe personash, fizikë ose juridikë, për ushtrimin e funksioneve, kompetencave, apo të drejtave që ligji Shqiptar dhe ky Statut i njëj Administratorit/ëve në fjalë.

Neni 15 **Eksperti kontabël i autorizuar**

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

TITULLI IV **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

Neni 16 **Viti Financiar dhe bilanci vjetor**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 17 **Fitimet**

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, pas zbritjes së të gjitha shumave që Asambleja e Ortakëve vendos të lërë rezervë, u shpërndahen ortakëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapital.
- 17.2 Në rastin kur Shoqëria ka një ortak të vetëm, Shoqëria mund t'i shpërndajë herë pas here fitime këtij Ortaku të vetëm.




- 17.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë për krijimin e një rezerve të jashtëzakonshme ose të veçantë.

TITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Shpërndarja

- 18.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të përcaktuar në Statut ose përpara këtij afati në rrethanat e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e parashikuar në nenin 12.3 më sipër.
- 18.2 Shoqëria, gjithashtu mund të ndahet ose të shkrihet me vendim të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me nenin 12.3 më sipër.

Neni 19 Likuidimi

- 19.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria duhet të likuïdohet.
- 19.2 Për administrimin e kësaj procedure, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë të cilët do të kenë kompetencat dhe detyrat e parashikuara nga ligji.
- 19.3 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të papaguara, likuidatori/ët do t'u shpërndajnë shumat e mbetura ortakëve në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

Neni 20 Kopjet

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale.

ORTAKËT

Në emër dhe për llogari të:

Z. Kristi Muçobega

Kristi Muçobega


Z. Armand Muçobega

Armand Muçobega
